

Gjykata e Qarkut Prizren  
P nr. 184/11  
11 janar 2012

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT PRIZREN**

Gjykata e Qarkut Prizren, e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it, Witold Jakimko, si kryetar i trupit gjykues për të mitur, dhe gjyqtarët Lulzim Paqarizi dhe Kymete Kicaj si anëtarë të kolegjit,

*Të ndihmuar nga:*


Natasa Malesevic, Tarik Mripa, Svetoslava Savova, Joseph Hollerhead, Jacqueline Ryan, Nexhmije Mezini, Vlora Johnston si proces-mbajtëse, Stephen Parkinson, Valentina Gashi dhe Tsvetelina Zhekova si proces-mbajtëse,

*Në lëndën penale kundër:*

1. Të pandehurit I.I.
2. Të pandehurit Sh.G.
3. Të pandehurit R.K.
4. Të pandehurit M.K.
5. Të pandehurit V.M.
6. Të pandehurit S.B.
7. Të pandehurit D.B.
8. Të pandehurit E.K.

*Të akuzuar*

Sipas Aktakuzës PP. nr. 3/2011, datë 16 maj 2011, të ushtruar nga Prokuroria e Qarkut Prizren më 17 maj 2011, të konfirmuar me Aktvendimin KA nr. 109/11 për konfirmimin e Aktakuzës, datë 28 korrik 2011, dhe të vendosur me Aktvendimin KA nr. 109/2011 me ankesë kundër Aktvendimit të datës 2 shtator 2011,



*Siç përshkruhet më poshtë:*

I pandehuri I.I

- I. Në një datë të panjohur në fund të nëntorit / fillim të dhjetorit 2010, nëpërmjet marrëveshjes paraprake me F. T dhe duke vepruar në bashkëkryerje me këtë të fundit, transportoi palën e dëmtuar të mitur, A.K, e mitur e moshës 15 vjeç, nga Shtime në Gjilan, Kosovë. Në një datë të mëvonshme në fund të nëntorit / fillim të dhjetorit 2010, i akuzuari dhe F.T e transferuan palën e dëmtuar tek të bashkë-akuzuarit R.K dhe M.K, respektivisht menaxher dhe pronar të restorant " " në Kamenicë, për qëllime të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që në restorant " " A.K u detyrua si fëmijë të qëndrojë atje dhe të punojë si kërcimtare nate për të paktën tre ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks.

Me çka ai kreu veprën penale të *Trafikimit të Personave* sipas Nenit 139, paragrafi 2, lidhur me nenin 139 paragrafi 1, dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Të pandehurit R.K dhe M.K

- II. Në një datë të paditur në fillim deri në mesin e dhjetorit 2010, respektivisht si menaxher dhe pronar të restorantit " " në Kamenicë, Kosovë, morën palën e dëmtuar të mitur A.K nga F.T dhe i bashkë-akuzuari I.I, për qëllime të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që në restorantin " " , A.K u detyrua si fëmijë të qëndronte dhe të punonte si kërcimtare nate për të paktën tre ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks.

Me çka ata kryen veprën penale të *Trafikimit të Personave*, sipas Nenit 139, paragrafi 2, lidhur me nenin 139 paragrafi 1, dhe nenin 23 të KPK-së.

I pandehuri M.K

- III. Në një datë të paditur në fillim deri në fund të dhjetorit të vitit 2010, me vetëdije nuk veproi në përputhje me Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, duke punësuar një fëmijë (A.K) pesëmbëdhjetë vjeç për ta angazhuar në punë që ishte e dëmshme për zhvillimin e saj (neni 7), dhe angazhoi një individ nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (A.K) në punë nate (neni 27), duke i mohuar të drejtat që gëzonte punonjësja A.K.

Me çka ai kreu veprën penale të *Cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës*, sipas Nenit 182 të KPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPK-së.



I pandehuri Sh.G

- IV. Në një datë të paditur në fillim deri në mesin e dhjetorit 2010, si pronar i restorantit "Shqiponja" në fshatin Vlashnje, Prizren, e mori të dëmtuarën e mitur A.K nga F.T, dhe e strehoi atë për qëllimet e shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që në restorant , A.K u detyrua si fëmijë të qëndrojë dhe të punojë si kërcimtare nate për të paktën pesë ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks dhe ku asaj iu kërkua kjo gjë nga F.T

Me çka ai kreu veprën penale të *Trafikimit të Personave* sipas Nenit 139, paragrafi 2, lidhur me nenin 139 paragrafi 1, dhe nenin 23 të KPK-së.

- V. Në një datë të paditur në fillim deri në mesin e dhjetorit 2010, ai e privoi të dëmtuarën e mitur A.K nga liria duke e kyçur atë në një dhomë në katin më të lartë të restorantit " " për tre ditë, dhe ai dhe/ose individë që vepronin me urdhër të tij, e kthyen atë me forcë në atë restorant pasi ajo iku nga dhoma.

Me çka ai kreu veprën penale të *Privimit të kundërligjshëm nga liria*, sipas Nenit 162 paragrafët 1 dhe 4 të KPK-së.

- VI. Në një datë të paditur në mes të fund të dhjetorit 2010, me vetëdije nuk veproi në përputhje me Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, duke punësuar një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte e dëmshme për zhvillimin e saj (neni 7), angazhoi një individ nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (A.K) në punë nate (neni 27), dhe punësoi një individ (A.K) nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç për më shumë se 30 orë në javë (neni 20), duke i mohuar kështu të drejtat që gëzonte punonjësja A.K.

Me çka ai kreu veprën penale të *Cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës*, sipas Nenit 182 të KPK-së.

I pandehuri V.M

- VII. Në një datë të paditur në mes të fund të dhjetorit 2010, me kërkesën e të bashkakuzuarit S.B, me dijeninë që e dëmtuara e mitur A.K ishte më e re se mosha e saj e deklaruar 19 vjeç, dhe me dijeninë që S.B kishte të ngjarë t'i gjente asaj punësim në një kazino, e transportoi të dëmtuarën e mitur A.K me Opel Vectran e tij për te motel në Prizren, pagoi dhomën e saj (efektivisht duke e strehuar) dhe i dha asaj numrin e telefonit të S. B, duke mundësuar trafikimin e saj nga S.B.

Me çka ai kreu veprën penale të *Lehtësimit të kryerjes së trafikimit me njerëz nga pakujdesia*, sipas Nenit 139 paragrafi 4 të KPK-së.



I pandehuri S.B

- VIII. Në një datë të panjohur në mes deri në të fund të dhjetorit 2010, bashkë me V.Mn, e strehoi të dëmtuarën e mitur A.K në hotel , Prizren, dhe duke vepruar në bashkëkryerje me të bashkakuzuarin D.B dhe për qëllime të shfrytëzimit të të dëmtuarës, e transferoi atë te " , i D. B, ku ajo në fakt u shfrytëzua në mënyrë të tillë që ajo punoi si kameriere nate në rrethana ku ajo do të ishte e cenueshme ndaj kërkesave për seks, dhe kjo gjë iu kërkuar nga D.B.

Me çka ai kreu veprën penale të *Trafikimit të Personave*, sipas Nenit 139 paragrafi 2, lidhur me nenin 139 paragrafi 1, dhe nenin 23 të KPK-së.

- IX. Në dy data të paditura në mes e deri në fund të dhjetorit 2010 në Prizren, e bëri të dëmtuarën e mitur A.K objekt të një akti seksual, duke kryer marrëdhënie seksuale me të në shtëpinë e dhëndrit të axhës të V.Mt dhe në shtëpinë e tij të ndodhur në "

Me çka ai kreu veprën penale të *Keqpërdorimi seksual të personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vite*, sipas Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së.

I pandehuri D.B

- X. Më ose rreth datës 24 dhjetor 2010, si menaxher i "Piano Bar Kazino" në Prizren, mori të dëmtuarën e mitur A.K nga i bashkakuzuari S.B, për qëllime të shfrytëzimit të saj në mënyrë të tillë që në " si fëmijë, A.K punoi si kameriere nate, në rrethana në të cilat ajo ishte e cenueshme ndaj kërkesave për seks, dhe kjo gjë iu kërkuar nga vetë i akuzuari.

Me çka ai kreu veprën penale të *Trafikimit të Personave*, sipas Nenit 139 paragrafi 2, lidhur me nenin 139 paragrafi 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

- XI. Në data të paditura ndërmjet 24.04.2010 dhe 31.12.2010, e bëri të dëmtuarën e mitur A.K objekt të një akti seksual, duke kryer marrëdhënie seksuale me të.

Me çka ai kreu veprën penale të *Keqpërdorimit seksual të personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vite*, sipas Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së.

- XII. Ndërmjet 24.12.2010 dhe 31.12.2010, me dijëni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës 2010/03-L-212, duke punësuar një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj (Neni 7), angazhoi një person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (A.K) në punë nate (Neni 27), dhe punësoi një person (A.K) nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç për më shumë se 30 orë në javë (Neni 20), duke kufizuar në këtë mënyrë të drejtat që gëzonte punonjësja A.K.



Me çka ai kreu veprën penale të *Cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës*, sipas Nenit 182 të KPK-së.

I pandehuri E.K

XIII. Më 05.01.2011, si pronar i në Prizren, e mori të dëmtuarën e mitur A.K nga dy persona të panjohur, me qëllim të shfrytëzimit të saj në mënyrë të tillë që i akuzuari e pajtoi të dëmtuarën për të punuar si kërcimtare nate në "Emona 2000", në rrethana në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks.

Me çka ai kreu veprën penale të *Trafikimit të Personave*, sipas Nenit 139 paragrafi 2, lidhur me nenin 139 paragrafi 1 të KPK-së.

XIV. Më 05.01.2011, me dijëni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, dhe punësoi një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj (Neni 7), duke i mohuar kështu të drejtat që gëzonte punonjësja A.K.

Me çka ai kreu veprën penale të *Cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës*, sipas Nenit 182 të KPK-së.


*pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor që ishin të mbyllura për publikun* më 8, 9 dhe 10 nëntor 2011, më 6, 7, 15 dhe 21 dhjetor 2011, dhe më 10 janar 2012, në prani të të pandehurit I.I me mbrojtësin e tij Hylki Kurtaj, të pandehurit Sh.G me mbrojtësin e tij Hazer Susuri, të pandehurit R.K me mbrojtësin e tij Bahrije Besimi, të pandehurit M.K me mbrojtësin e tij Arda Mustafe, të pandehurit V.M me mbrojtësin e tij Brahim Sopa, të pandehurit S.B me mbrojtësin e tij Naim Qelaj, të pandehurit D.B me mbrojtësin e tij Ramiz Krasniqi, të pandehurit E.K me mbrojtësin e tij Skënder Morina, Prokurorit Publik të EULEX-it, Cezary Michalczuk, dhe Prokurorit Publik të Qarkut, Agron Matjani, të dëmtuarës A.K me punonjësën e saj sociale Grace Dartey dhe mbrojtësin e saj Hajrip Krasniqi,

*shqipton këtë:*

## AKTGJYKIM

1. I pandehuri I.I:

I pandehuri **I.I shpallet fajtor** sepse në një datë të paditur në fund të nëntorit / fillim të dhjetorit 2010, nëpërmjet një marrëveshjeje paraprake me F.T dhe duke vepruar në bashkë-kryerje me këtë të fundit, e transportoi të dëmtuarën e mitur A.K, e mitur e moshës 15 vjeç, nga Shtime në Gjilan, Kosovë. Në një datë të mëpasme në fund të



nëntorit/fillim të dhjetorit 2010, i akuzuari dhe F.T e transferuan të dëmtuarën në restorant ' ' në Kamenicë, me qëllim të shfrytëzimit të saj,

kështu ai kreu veprën penale të trafikimit të personave, sipas Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 139 paragrafi 1 dhe Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 66 paragrafi 2, Nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 1 (një) vit;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPK-së, Gjykata përfshin në dënim kohën e kaluar nga I.I në paraburgim nga 7.1.2011 deri në 3.4.2011, dhe në arrest shtëpiak nga 3.4.2011 deri në 13.5.2011;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të KPK-së, gjykata vendos që, për qëllim të dënimit të caktuar ndaj I.It, aktgjykimi përfundimtar mund të shpallet në shtyp ose radio ose televizion;

## 2. Të pandehurit M.K dhe R.K:

Të pandehurit **M.K dhe R.K shpallen fajtorë** sepse në një datë të paditur në fillim deri në mes të dhjetorit 2010, përkatësisht si pronar dhe punonjës të restorantit " " në Kamenicë, Kosovë, e morën të dëmtuarën e mitur A.K nga F.T dhe i bashkakuzuari I.I, me qëllim të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që në restorant , A.K u detyrua si fëmijë të qëndrojë dhe punojë si kërcimtare nate për të paktën tre ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks,

kështu ata kryen veprën penale të trafikimit të personave, sipas Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 139 paragrafi 1 të KPK-së dhe Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 66 paragrafi 2, Nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPK-së, Gjykata i dënon të dy ata me burgim në afat 1 (një) vit;

I pandehuri **M.K shpallet fajtor** sepse në një datë të paditur në fillim deri në fund të dhjetorit 2010, me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, duke punësuar një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj (Neni 7) dhe angazhoi një person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (A.K) në punë nate (Neni 27), duke i mohuar kështu të drejtat që gëzonte punonjësja A.K,

kështu, ai kreu veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës, sipas Nenit 182 të KPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 182 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 6 (gjashtë) muaj;

Në bazë të Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPK-së, për veprat penale të njëkohshme të përshkruara në këtë aktgjykim, Gjykata cakton ndaj **M.K dënimin unik** me burgim në afat 1 (një) vit dhe 1 (një) muaj;



Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të KPK-së gjykata vendos që, për qëllim të dënimit të caktuar ndaj M.Kt dhe R.Kt, aktgjykimi përfundimtar mund të shpallet në shtyp ose radio ose televizion;

### 3. I pandehuri SH.G:

I pandehuri **Sh.G shpallet fajtor** sepse në një datë të paditur në fillim deri në mes të dhjetorit 2010, si pronar i restorant " " në Fshatin , Prizren, e mori të dëmtuarën e mitur A.K nga F.T, dhe e strehoi atë me qëllim të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që në " ", A.K u detyrua si fëmijë të qëndrojë dhe të punojë si kërcimtare nate për të paktën pesë ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks dhe ku kjo gjë iu kërkua nga F.T,

kështu, ai kreu veprën penale të trafikimit të personave sipas Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 139 paragrafi 1 dhe Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 4 (katër) vite;

I pandehuri **Sh.G shpallet fajtor** sepse, në një datë të paditur në fillim deri në mes të dhjetorit 2010, e privoi të dëmtuarën e mitur A.K nga liria, duke e kyçur atë në një dhomë në katin më të lartë të "restorantit " dhe ai dhe/ose persona të tjerë që vepronin nën fuqinë e tij, e kthyen atë me forcë në atë restorant pasi ajo u largua nga dhoma për të shpëtuar,

kështu, ai kreu veprën penale të privimit të paligjshëm të lirisë, sipas Nenit 162 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 162 paragrafi 4, lidhur me Nenin 162 paragrafi 1 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj;

I pandehuri **Sh.G shpallet fajtor** sepse, në një datë të paditur në mes deri në fund të dhjetorit 2010, me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, duke punësuar një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj (Nenin 7), angazhoi një person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (A.K) në punë nate (Nenin 27), dhe punësoi një person (A.K) nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç për më shumë se 30 orë në javë (Neni 20), duke i mohuar kështu të drejtat që gëzonte punonjësja A.K,

kështu, ai kreu veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës, sipas Nenit 182 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 182 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 6 (gjashtë) muaj;

Në bazë të Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPK-së, për veprat penale të njëkohshme të përshkruara në këtë aktgjykim, Gjykata cakton ndaj Sh.Gt **dënimin unik** me burgim në afat 4 (katër) vite dhe 1 (një) muaj;



kryer marrëdhënie seksuale me të në shtëpinë e dhëndrit të axhës së V.Mt dhe në shtëpinë e tij të ndodhur në ' ,

kështu, ai kreu veprën penale të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeç, sipas Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 1 (një) vit;

Në bazë të Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPK-së, për veprat penale të njëkohshme të përshkruara në këtë aktgjykim, Gjykata cakton ndaj S.B **dënimin unik** me burgim në afat 1 (një) vit dhe 1 (një) muaj;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPK-së, Gjykata përfshin në dënim kohën e kaluar nga S.B në paraburgim nga 6.1.2011 deri në 11.11.2011;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të KPK-së, gjykata vendos që, për qëllim të dënimit të caktuar ndaj S. B, aktgjykimi përfundimtar mund të shpallet në shtyp ose radio ose televizion;

#### 6. I pandehuri D.B:

I pandehuri **D.B shpallet fajtor** sepse, më ose rreth datës 24 dhjetor 2010, si menaxher i "ar" në Prizren, e mori të dëmtuarën e mitur A.K nga i bashkakuzuari S.B, me qëllim të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që në ' ', duke qenë fëmijë A.K punoi si kameriere gjatë natës në rrethana në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks, dhe kjo gjë iu kërkua nga vetë i akuzuari,

kështu, ai kreu veprën penale të trafikimit të personave, sipas Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 139 paragrafi 1, dhe Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 66 paragrafi 2, Nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 1 (një) vit;

I pandehuri **D.B shpallet fajtor** sepse, në data të paditura ndërmjet 24.04.2010 dhe 31.12.2010, e bëri të dëmtuarën e mitur A.K objekt të një akti seksual, duke kryer marrëdhënie seksuale me të,

kështu, ai kreu veprën penale të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeç, sipas Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 1 (një) vit;

I pandehuri **D.B shpallet fajtor** sepse, ndërmjet datave 24.12.2010 dhe 31.12.2010, me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, duke punësuar një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj (Neni 7), angazhoi një person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (A.K) në punë nate (Neni 27), dhe punësoi një person (A.K) nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç për





më shumë se 30 orë në javë (Neni 20), duke kufizuar në këtë mënyrë të drejtat që gëzonte punonjësja A.K,

kështu, ai kreu veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës, sipas Nenit 182 të KPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 182 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 6 (gjashtë) muaj;

Në bazë të Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPK-së, për veprat penale të njëkohshme të përshkruara në këtë aktgjykim, Gjykata caktën ndaj D.B **dënimin unik** me burgim në afat 2 (dy) vite;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPK-së, Gjykata përfshin në dënim kohën e kaluar nga D.B në **paraburgim** nga 7.1.2011 deri në 11.11.2011;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të KPK-së, gjykata vendos që, për qëllim të dënimit të caktuar ndaj D. B, aktgjykimi përfundimtar mund të shpallet në shtyp ose radio ose televizion;

#### 7. I pandehuri E.K:

I pandehuri **E.K shpallet fajtor** sepse, më 05.01.2011, si pronar i në Prizren, e mori të dëmtuarën e mitur A.K nga dy persona të panjohur me qëllime të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që i akuzuari e pajtoi të dëmtuarën për të punuar si kërcimtare nate në " ", në rrethana në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks,

kështu, ai kreu veprën penale të trafikimit të personave, sipas Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 139 paragrafi 1, dhe Nenin 23 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 139 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenin 66 paragrafi 2, Nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 1 (një) vit;

I pandehuri **E.K shpallet fajtor** sepse, më 05.01.2011, me dijëni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L- 212, dhe punësoi një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj (Neni 7), duke i mohuar kështu të drejtat që gëzonte punonjësja A.K,

kështu, ai kreu veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës, sipas Nenit 182 të KPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 182 të KPK-së, Gjykata e dënon atë me burgim në afat 6 (gjashtë) muaj;

Në bazë të Nenit 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPK-së, për veprat penale të njëkohshme të përshkruara në këtë aktgjykim, Gjykata cakton ndaj E.K **dënimin unik** me burgim në afat 1 (një) vit dhe 3 (tre) muaj;



Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPK-së, Gjykata përfshin në dënim kohën e kaluar nga E.K në **paraburgim** nga 5.1.2011 deri në 22.3.2011;

Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të KPK-së, Gjykata vendos që, për qëllim të dënimit të caktuar ndaj E.Kt, aktgjykimi përfundimtar mund të shpallet në shtyp ose radio ose televizion;

Në bazë të Nenit 102 paragrafi 1 dhe 3 të KPPK-së, të gjithë të pandehurit urdhërohen të paguajnë bashkërisht shpenzimet e procedurës penale.

## ARSYETIM

### I. Ecuria procedurale

Më 7 janar 2011 Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren shqiptoi aktvendimin për fillimin e hetimeve kundër V.M, E.K, I.I, F.T, Sh.G, S. B. dhe D. B.

Më 7 janar 2011 Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës së Qarkut Prizren caktoi paraburgimin për një muaj kundër të gjithë të dyshuarve. Më 11 janar 2011 kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren i hodhi poshtë ankesat kundër aktvendimit.

Më 2 shkurt 2011 kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren e vazhdoi paraburgimin për dy muaj kundër të gjithë të dyshuarve. Më 11 shkurt 2011 Gjykata Supreme e Kosovës i hodhi poshtë ankesat kundër aktvendimit.

Më 28 shkurt 2011 Nënkryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ia caktoi lëndën Gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut Prizren.

Më 22 mars 2011 Gjyqtari i Procedurës Paraprake i EULEX-it i Gjykatës së Qarkut Prizren e ndërpreu paraburgimin kundër E.Kt. Prokurori Publik kërkoi ndërprerjen sepse gjetën se nuk kishte dyshim të bazuar kundër K.

Më 1 prill 2011, Gjyqtari i Procedurës Paraprake i EULEX-it i Gjykatës së Qarkut Prizren e ndërpreu paraburgimin kundër V.M dhe I.I dhe e ndryshoi atë me arrest shtëpiak, dhe e vazhdoi paraburgimin kundër Sh.G, S. B dhe D. B për një muaj. Më 7 prill 2011, kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren e plotësoi dispozitivin e aktvendimit në pjesët për V.Mn dhe I.In, duke theksuar datat e sakta të arrestit shtëpiak.

Më 29 prill 2011 Prokurorit Publik i Qarkut i zgjeroi hetimet kundër R.K dhe M.K.

Më 3 maj 2011, kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren e vazhdoi paraburgimin kundër Sh.Gt, S. B. dhe D. B, dhe arrestin shtëpiak kundër V.M dhe I.I për dy muaj. Më 13 maj



2011, Gjykata Supreme e Kosovës e zëvendësoi arrestin shtëpiak të M. dhe I. me paraqitjen në stacionin policor qendror në Prizren dy herë në javë.

Më 5 maj 2011, Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës së Qarkut Prizren caktoi paraqitje në stacionin policor për një muaj kundër R.Kt dhe M.Kt.

Më 17 maj 2011, Prokurorit Publik i Qarkut ushtroi aktakuzën në Gjykatën e Qarkut Prizren.

Më 20 maj 2011, kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren e vazhdoi paraburgimin kundër Sh.Gt, S. B dhe D.B. Më 2 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës i hodhi poshtë ankesat kundër aktvendimit.

Më 28 korrik Gjyqtari i EULEX-it për konfirmimin e aktakuzës e konfirmoi pjesërisht aktakuzën. Sh.G, S.B dhe D.B u lanë përsëri në paraburgimin. Të tjerët u liruan nga paraburgimi ose paraqitja në stacionin policor.

Më 2.9.2011, kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren e miratoi pjesërisht ankesën e Prokurorit Publik.

Më 2.9.2011, kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren e vazhdoi paraburgimin kundër Sh.Gt, S. B dhe D. B deri në 5.11.2011.

Më 5.9.2011 kolegji i Gjykatës së Qarkut Prizren, duke vendosur sipas detyrës zyrtare për paraburgimin, e vazhdoi paraburgimin kundër të pandehurve Sh.G, S.B dhe D.B deri në 05.11.2011.

Më 14.9.2011, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë ankesën kundër aktvendimit të paraburgimit, të ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit Sh.G.

Më 03.11.2011 kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Qarkut Prizren, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, në bazë të Nenit 287 paragrafi 2 të KPPK-së, e vazhdoi paraburgimin kundër të pandehurve Sh.G, S.B dhe D.B për dy muaj deri në 5.01.2012.

Më 11.11.2011 kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Qarkut Prizren vendosi për zëvendësimin e paraburgimit për këta dy të pandehur me paraqitje në stacionin policor deri në 5 janar 2012.

Më 11.01.2012, trupi gjykues që shqiptoi aktgjykimin në shkallë të parë, e anuloi paraburgimin e Sh.Gt dhe anuloi paraqitjen në stacionin policor të S. B. dhe D. B.



## II. Provat e administruara

Gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, u dëgjuan këta dëshmitarë:

i. A.K – e dëmtuar,

Gjendja faktike bazohet kryesisht në deklaratën e saj në pjesën e konfirmuar gjatë seancës gjyqësore, dhe në pjesën e dëshmisë që ajo dha në fazën hetimore duke marrë parasysh shkallën e shmangies prej tyre gjatë seancës gjyqësore. Për mendimin e Gjykatës, kjo e fundit konsideroi më të besueshme dëshminë që ajo dha menjëherë pas ndodhjes së veprave penale të kryera kundër të dëmtuarës. Kujtesa e saj ishte më e freskët në atë kohë edhe duke pasur parasysh varësinë e saj nga droga. Nga ana tjetër, gjatë seancave gjyqësore ajo pati tendencën t'i shfajësonte të pandehurit nga akuzat. Megjithatë vlen të theksohet se e dëmtuara ka qenë mjaft konsekuente lidhur me elementet kryesore të gjendjes faktike të raportuar në polici ose prokurori në përgjithësi.

ii. G. G;


Dëshmitari pranoi se e dëmtuara përdorte drogë. Ajo nuk mori alkool kur ai ishte barist. Ai nuk kishte dijeni të gjerë në çështjen e lidhur me akuzat kundër Sh.Gt, përveç faktit se ai pranoi se e dëmtuara ishte kërcimtare në Restorant . Ai deklaroi se T., personi i përfshirë në trafikim, po kërkonte A.K dhe ai i tha Sh.G se do t'i vinte zjarrin restorantit të tij. Deklarata nuk kishte karakter vendimtar lidhur me gjendjen faktike.

iii. S. G;

Ky dëshmitar ishte kamerier në Restorant . Sipas dëshmitarit, A.K i provokonte klientët. Ai deklaroi se e njihnte V.M si klient të rregullt të Restorantit . Ai nuk solli ndonjë informacion kritik për gjendjen faktike.

iv. B. H; 10 nëntor 2011.

Dëshmitari B. H konfirmoi faktin se A.K punonte në Restorant si kërcimtare, konfirmoi orët e punës së saj, dhe se ajo i kërkoi atij drogë, se ajo e përdorte drogën. Dëshmia e tij ishte e besueshme por nuk pati karakter vendimtar për gjendjen faktike. Ai konfirmoi se 4 persona e



kthyen T. në restorant: nipi i Sh.it, vëllai i Sh.it, I, G. dhe L. Nga deklarata e mëparshme e tij, del se këta katër persona e mbanin atë për krahësh. Sh.G ishte jashtë dhe e pa gjithë ngjarjen.

v. Y. S;

Ai festoi vitin e ri bashkë me A.K. Ai jetonte në të njëjtën ndërtesë ku ishte dhe D.B. Ai nuk i dha Gjykatës shumë hollësi që mund të ishin shumë relevante për gjendjen faktike.

vi. F. B;


Dëshmitari i ndihmonte njerëzit të merrni paratë për fitimet e tyre në A.K punoi atje si kameriere gjatë ndërresave të natës. Ajo punoi atje rreth 7 ditë. Sipas tij, paga mujore e saj ishte 300 euro. Ai nuk arriti t'i jepte Gjykatës më shumë hollësi.

vii. E. K;

Dëshmitari punonte për D. B në Ai e njëjtte të dëmtuarën dhe se ajo merrte një rrogë prej 350 eurosh në muaj. Ai pranoi se A.K u soll në r nga S.B.

viii. B. L;

Dëshmitarja punonte në Restorant si kërcimtare. Ajo pretendoi se Sh.G ishte tepër ndihmës për të, veçanërisht gjatë përmytjes në Shqipëri, nga vjen ajo. Gjykata nuk e konsideroi të besueshme deklaratën e dëshmitares se A.K dukej më e madhe në moshë, ose fizikisht më e madhe se mosha e saj. Ky qëndrim nuk i reziston vlerësimit objektiv bazuar në fotot që u përfshinë në tërësinë e provave si Ekspoziti 1. Ajo deklaroi se vishte rroba të rregullta kur kërcente. Ajo pretendoi se Sh.G këmbënguli që A. t'i jepte atij letërnjoftimin dhe ajo nuk e bëri këtë. Ajo pranoi në të njëjtën kohë që A.K e vazhdoi punën e saj në Shqiponja. B.L vërejti gërvishtje në qafën e A.ës. Sipas dëshmitares, ajo e kishte bërë vetë këtë në përpjekje për të hapur derën e dhomës. Kur u pyet nga një anëtar i trupit gjykues, B. L deklaroi se kjo ndodhi kur A. po përpiquej të hapte derën në momentin kur ajo u kyç në dhomë dhe të gjithë të tjerët kërcenin dhe punonin në restorant.




- Si Eksponat A1 - Kopjet e pasaportës së A.Kt dhe fotot e A.Kt të këqyrura nga anëtarët e trupit gjykues. Nga këto prova mund të vlerësohet lehtësisht dhe objektivisht mosha e vërtetë e së dëmtuarës. Për mendimin e Gjykatës, çdo vlerësim i arsyeshëm i këtij tipari duhet të shpjerë në përfundimin që ajo ishte e mitur, maksimumi e moshës 15 vjeç.

- Si Eksponat A2 - Raport i shtypur i SMS-ve hyrëse dhe dalëse të numrave të telefonit të cekur në Aktakuzë, në formën e transkripteve,

- Si Eksponat A3 - Transkriptet e regjistrimeve të bisedave telefonike të V.Mt me një person të panjohur më 05/01/2011, në bazë të urdhrin të PPQ Durguti, datë 05.01.11, të konfirmuar nga Gjykata e Qarkut Prishtinë, Gjyqtarja e Procedurës Paraprake, Shqipe Qerimi, datë 06.01.11. Komentet për eksponatet 2 dhe 3 jepen më poshtë në arsyetim. Shih gjithashtu faqen 13, proces-verbali i datës 15 dhjetor 2011. T. nga Tirana hyri në kontakt me A.Kn në një restorant në Tiranë. Ky person e mori A.K dhe e solli atë në Kukës me një kombi, dhe pastaj ia shiti atë F (V) Tës nga Shistaveci në Kukës. Pastaj ky person thirri më pas V.M sepse ai fillimisht kontaktoi [REDAKTUAR] muzikant në restorant [REDAKTUAR]. Më vonë ata u takuan në Prizren, V.M takoi personin e quajti T. në Prizren dhe S. B dhe [REDAKTUAR] ishin atje në një restorant në [REDAKTUAR], të quajtur restorant [REDAKTUAR] dhe atje ata biseduan se dëshironin ta merrnin atë. Gjatë kohës së bisedës, V.M nuk ra dakord t'ia jepte A.K T.. Megjithatë duke pasur parasysh moshën e të dëmtuarës, si dhe gjithë rrethanat në Kosovë në lidhje me atë lloj procedure, ai kishte njohuri dhe e strehoi atë. Pasi e mori atë nga restorant [REDAKTUAR], ai e mori atë në automjetin e tij dhe e dërgoi në motel. Bashkë-kryerësit e tjerë të trafikimit të personave, F.T dhe T., të cilët nuk ishin të pandehur në këtë lëndë, gjetën detajet e V.M. V.M dhe S. B kishin biseduar më parë; ata hynë në kontakt me njëri-tjetrin në Restorant [REDAKTUAR].

Të gjithë të pandehurit u dëgjuan gjatë shqyrtimit kryesor dhe dëshmitë e tyre u bënë gjithashtu objekt vlerësimi nga ana e gjykatës.

Gjykata nuk u mbështet në deklaratën e I.I se ai merrej vetëm me biznesin e vëçave, sepse provat e tjera (kryesisht eksponatet dhe deklaratat e të dëmtuarës) e shpuan Gjykatën në një përfundim tjetër. Gjykata e konsideroi dëshminë e këtij të pandehuri të papranueshme.




por në të njëjtën linjë mbrojtjeje të stilit të lirë që nuk ka mbështetje në provat e mbledhura nga Gjykata.

Gjykata ra dakord me të pandehurin R.K se ndoshta ai nuk ishte menaxher në restorantin ' ' por definitivisht ajo që ishte e mundur të përcaktohej ishte se ai ishte sigurisht punonjës i M.K. Në të njëjtën kohë ai veproi si ndërmjetës ndërmjet personave të cilët sollën A.ën, dhe pronarit të restorantit.

M.K konfirmoi se e pajtoi A.K, megjithëse pretendoi se këmbënguli t'i jepet letërnjoftimi i A.ës me të dhënat e moshës së saj. Megjithatë ai vendosi ta pajtonte atë dhe ajo filloi punën në restorantin e tij.

Sh.G pretendoi se u bazua në atë që e dëmtuara i tregoi atij për moshën e saj: që ajo është 19 vjeç. Ai nuk kontrolloi ndonjë dokument personal të saj, sepse ajo nuk kishte. Ai pretendoi se nuk dinte asgjë për familjen e saj, as për statusin financiar të saj. Ai pretendoi se ai e ndihmoi atë vetëm sepse ajo kishte nevojë për punë. Ai pretendoi se nuk e la atë të dilte nga Restorant ' ' , sepse ishte përgjegjës dhe jepte llogari për të nga ora 9 e darkës deri në 3 të mëngjesit, dhe ajo lejohej të largohej nga vendi gjatë orëve të punës vetëm sepse ishin orët e punës. Ai shpjegoi se, kur pa [REDACTED] që iu afrua A.ës dhe hyri në banjë, ai ndërhyri dhe e përjashtoi T. nga puna, dhe atë natë e dërgoi në dhomën e saj. Ai mohoi që e rrahu A.K dhe po kështu se e kyçi atë. Dëshmia e këtij të pandehuri nuk është në pajtueshmëri me provat e tjera. Sipas Sh.G, A.K dëshironte të largohej dhe të dilte pas orës 3 të mëngjesit, por për arsye sigurie ai nuk dëshironte ta linte atë të shkonte jashtë, dhe prandaj e fuste brenda. Aty afër ishte një rrugë, kishte automjete, ishte natë. Kur u pyet nga prokurori, i pandehuri u përgjigj se nuk i ndalonte vajzat e tjera të largoheshin për arsye sigurie, sepse vajzat e tjera nuk bënë ndonjë tentativë për t'u larguar. Gjykata e gjeti dëshminë e të dëmtuarës si të besueshme në këtë drejtim, në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratave të të pandehurit që nuk ishin të besueshme. Gjykata e konsideroi dëshminë e këtij të pandehuri si të papranueshme, por në të njëjtën linjë mbrojtjeje të stilit të lirë, që nuk ka mbështetje në provat e mbledhura nga Gjykata.



Sh.G pranoi se ishte A.K ajo që në fund u largua vetë nga restoranti i tij (dëshmia e tij dhënë më 21 dhjetor 2011).

V.M pranoi se ai i dha A.K numrin e telefonit të S. B. Ai pranoi gjithashtu se pagoi për hotelin e saj. Ai mohoi që e dërgoi të dëmtuarën në Bar. Ai pranoi gjithashtu se e njihnte D. B që në fëmijëri. Ai e pranoi përmbajtjen e bisedës së përgjuar. Ai nuk ishte i aftë të shpjegonte përse; ai pranoi gjatë fazës hetimore të procedurës se kontaktoi edhe me E.Kn lidhur me pajtimin e A.K në . Nëpërmjet kësaj linje mbrojtjeje, i pandehuri u përpoq të shmangte përgjegjësinë e tij, por sipas Gjykatës nuk ka dyshim se provat e mbetura mbizotërojnë dhe shpjen në përfundimin e pakundërshtueshëm se ai e kreu veprën penale me të cilën akuzohet.

S.B pranoi se po përpiquej të ndihmonte A.K duke i gjetur asaj punë. Në deklaratën e mëparshme të tij, S.B deklaroi se ajo i tha atij se në Restorant ajo u rrah nga pronari. Në Gjykatë ai mohoi edhe se i lexoi ato deklarata pas përfundimit të marrjes në pyetje nga policia. Ai pranoi se ishte V.M ai që pagoi për hotelin. Ai pretendoi se mendonte se ajo nuk ishte e mitur, ai e besoi atë se ajo është 19 vjeç. Ai pretendoi se policia në fazën hetimore ushtroi tryzni ndaj tij. Ai mohoi gjithashtu se kishte bërë seks me A.K. Versioni i ri dhe arsyeja përse u ndryshua nuk e bindi Gjykatën për besueshmërinë e S. B dhe dëshmia e tij nuk mundi t'i rezistojë forcës së pasojës së dëshmisë së dhënë nga A.K.

D.B pranoi se ndihmonte dajën e tij në duke vepruar si menaxher. Ai pranoi se pranoi që A.K të punonte në restorantin e tij. Ai i kërkoi asaj të jepte letërnjoftimin me moshën e saj. Por ajo filloi të punonte pa ia dhënë D. B ato dokumente. Ajo mendohej të punonte si bariste dhe kameriere. Ai i tha A.ës se nuk besonte se ajo ishte 19 vjeç (proces-verbali i datës 21 dhjetor 2011, f. 41). Ai pranoi orët saj të punës nga ora 8 e darkës deri në 4 të mëngjesit. Ai e mohoi deklaratën e mëparshme të tij dhënë në polici, ku kishte deklaruar se ajo i tha atij se e kishte rrahur pronari i Restorantit . Ai gjithashtu i mohoi deklaratat e saj se kishte bërë seks me A.ën, gjë që ndodhi disa herë: në fillim në motel , mote! dhe pastaj në , ku ata





bënë seks 2 a 3 herë. Për mendimin e Gjykatës, dëshmia e të pandehurit nuk ishte konsistente në vetvete. Ai nuk ishte në gjendje të shpjegonte përse pranoi gjatë fazës hetimore të procedurës se kishte pasur marrëdhënie seksuale me A.ën dhe pastaj e mohoi. I pandehuri, me linjën e tij të mbrojtjes, u përpoq ta minimizonte përgjegjësinë e tij, por sipas Gjykatës nuk ka dyshim se provat e tjera mbizotërojnë dhe shpjen në përfundimin e pakundërshtueshëm se ai i kreu veprat penale me të cilat akuzohet.


Kur e takoi të dëmtuarën, E.K e pyeti vajzën nëse ajo kishte punuar në ndonjë vend tjetër. Ajo i tha po, por ajo ishte e papunë atë kohë. Ajo i tha E.K se ishte 19 vjeç, megjithëse dukej disi më e re, dhe se E.K i kërkoi asaj dokumentet dhe ajo i tha se do t'ia sillte të nesërmen. Megjithatë ai vendosi ta punësonte dhe ajo filloi punë në . Një orë më pas erdhi policia. Orët e punës së saj ishin nga 8 e mbrëmjes deri në 2 të mëngjesit. Ata ranë dakord për rrogën prej 10 eurosh në natë. Deri-diku i pandehuri i pranoi të gjitha detajet që ishin bindëse në përcaktimin e akteve kriminale të tij. I pandehuri, nëpërmjet linjës së tij të mbrojtjes, u përpoq ta minimizonte përgjegjësinë e tij, por, sipas Gjykatës, nuk ka dyshim se ai e mori të dëmtuarën nga personat e panjohur, e punësoi dhe filloi ta shfrytëzonte atë në biznesin e tij. Sipas Gjykatës, qëndrimi se i pandehuri nuk kishte dijeni për pozitën e së dëmtuarës, nuk ka mbështetje në provat e mbledhura nga Gjykata.

Provat që ndikojnë në gjetjet e Gjykatës shtjellohen qartë në paragrafët vijues. Provat e tjera nuk kishin ndikim të drejtpërdrejtë në përmbajtjen përfundimtare të dispozitivit.

#### **IV. Gjendja faktike**

E dëmtuara A.K u transportua në Kosovë nga Shqipëria nga F.T. I.I e njëjtte F.T.ën që dy vite para se të ndodhte situata inkriminuese (deklaratë e I.IT dhënë më 15 dhjetor, f. 16).

I pandehuri i parë që ajo takoi në Kosovë ishte I.I. Në një datë të paditur në fund të nëntorit/fillim të dhjetorit 2010, përmes një marrëveshjeje paraprake me F.T dhe bashkë me të, I.I e transportoi A.Kn nga Shtime në Gjilan në Kosovë. Ajo ishte e mitur, e moshës 15 vjeç. Në një datë të mëpasme në fund të nëntorit/fillim të dhjetorit 2010




dhe F.T e transferuan A.K në restorantin ' ' në Kamenicë, me pronar M.Kn. Ajo do të punonte atje si kërcimtare.

I pandehuri M.K – siç u cek më lart – pronari i restorantit ' ', dhe R.K, punonjësi i tij, në një datë të paditur në fillim deri në mes të dhjetorit 2010 në restorantit ' ' në Kamenicë në Kosovë, e morën A.K nga F.T dhe i bashkë-pandehuri tjetër, I.I. A.K qëndroi atje dhe punoi si kërcimtare gjatë natës për të paktën tre ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks nga klientët e restorantit. Për më tepër, M.K me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212. Ai e punësoi A.Kn, me gjithë moshën e saj, e angazhoi atë në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj, dhe e angazhoi në punë nate. Duke bërë këtë, ai i mohoi asaj të drejtat që gëzonte ajo si punonjëse.

I pandehuri Sh.G ishte pronar i restorant ' ' në Fshatin ' ', Prizren. Në një datë të paditur në fillim deri në mes të dhjetorit 2010, ai e mori A.K nga F.T dhe e strehoi atë me qëllim të shfrytëzimit të saj në restorant ' '. A.K u detyrua si fëmijë të qëndrojë dhe punojë si kërcimtare gjatë natës për të paktën pesë ditë, në rrethana ku ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks dhe ku kjo gjë iu kërkua nga F.T. Sh.G, në një datë të paditur në fillim deri në mes të dhjetorit 2010, e privoi A.K nga liria duke e kyçur atë në një dhomë në katin më të lartë të Restorantit ' '. Pastaj ai dhe/ose persona të tjerë që vepronin nën fuqinë e tij, e kthyen atë me forcë në atë restorant pasi ajo u largua nga dhoma për të shpëtuar. Në të njëjtën kohë, Sh.G, në një datë të paditur në mes deri në fund të dhjetorit 2010, me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212. Ai e punësoi A.K, me gjithë moshën e saj, e angazhoi atë në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj: ai e angazhoi atë në punë nate. Për më tepër, ajo gjithashtu u punësua për më shumë se 30 orë në javë. Me këtë ai i mohoi asaj të drejtat që i takonin asaj si punonjëse. Në fund ajo u largua vetë nga Restorant ' '.

I pandehuri tjetër, V.M, në një datë të paditur në mes deri në fund të dhjetorit 2010, me kërkesë të bashkë-pandehurit S.B, me dijeninë se A.K ishte më e re se mosha e deklaruar e saj 19 vjeç, dhe me dijeninë se S.B kishte të ngjarë të gjente punësim për të në një kazino, e transportoi të dëmtuarën e mitur A.K me Opel Vectran e tij në motel ' ' në Prizren. V.M pagoi për dhomën e saj (faktikisht duke e strehuar atë) dhe i dha



asaj numrin e telefonit të S. B dhe, duke vepruar kështu, ai mundësoi trafikimin e saj nga S.B.


I pandehuri S.B, duke vepruar në një datë të paditur në mes deri në fund të dhjetorit 2010, duke vepruar në bashkëkryerje me të bashkë-pandehurin D.B dhe me qëllim të shfrytëzimit të saj, e transferuan A.Kn nga Hotel në Prizren tek i D. B. Në ndërkohë, S.B, në dy data të paditura në mes deri në fund të dhjetorit 2010 në Prizren, e bëri A.K objekt të një akti seksual, duke kryer marrëdhënie seksuale me të në shtëpinë e dhëndrit të axhës së V.Mt dhe në shtëpinë e tij të ndodhur në

I pandehuri D.B ishte menaxher i në Prizren, te i cili e transferuan A.K më ose rreth datës 24 dhjetor 2010. Ai e mori A.K nga i bashkë-pandehuri S.B, me qëllim të shfrytëzimit të saj, në mënyrë të tillë që, në

A.K punoi si kameriere gjatë natës, në rrethana në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks, dhe kjo gjë iu kërkua nga vetë i akuzuari në data të paditura ndërmjet 24.04.2010 dhe 31.12.2010, kur ai e bëri atë objekt të një akti seksual, duke kryer marrëdhënie seksuale me të. Në të njëjtën kohë, ai me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, duke e punësuar A.K, duke e angazhuar atë në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj, në punë nate, dhe për më shumë se 30 orë në javë. Me këtë ai kufizoi të drejtat që gëzonte A.K.

I pandehuri E.K, pronar i në Prizren, më 05.01.2011 e mori A.K nga dy persona të panjohur, me qëllim të shfrytëzimit të saj. I pandehuri e punësoi atë për të punuar si kërcimtare, gjatë natës në në rrethana në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks. Ai i tha asaj të largohej në rast se në lokal hynte policia. E.K, më 05.01.2011, me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, 2010/03-L-212, dhe e punësoi A.Kn me gjithë moshën e saj; ai e angazhoi atë në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj. Me këtë ai i mohoi të drejtat që ajo gëzonte si punonjëse.

Trafikimi i A.Kt ishte periudhë shumë traumatike në jetën e saj. Pasojë e kësaj mbi të ishte humbja e përqendrimit, tendenca për t'u acaruar, administrimi i gabuar i zemërimit. Ajo mërzitej shumë shpejt. Ajo u stresua, filluan t'i dridhen duart dhe gjithë trupi dhe si pasojë tjetër e keqe ishin ëndrrat e këqija dhe makthet, që i referoheshin se



kaluarës. Në Angli ajo kishte marrë përkrahje psikologjike dhe këshillim për administrimin e zemërimit (deklaratë e A. K, f. 27, proces-verbal i datës 9 nëntor 2011).

## V. Gjetjet ligjore


### I.I

Për mendimin e Gjykatës, nuk kishte dyshim lidhur me faktin se I.I veproi me qëllim të “shfrytëzimit” të të dëmtuarës. Fakti që A.K dha deklaratë se ajo e kishte konsideruar këtë të pandehur si “vëllanë” e saj që e ndihmoi – nuk e paragjykon mungesën e qëllimit të lart-përmendur. Për mendimin e Gjykatës, pretendimi se viktimja ishte e dashur e F.T është dhe se “vozitja e tyre ishte vetëm një akt / shërbim miqësor për F. T” është vetëm një mënyrë e pranueshme mbrojtjeje nga ana e I.IT, dhe nuk bazohet me gjendjen faktike. I.I ishte i vetëdijshëm se veproi jo vetëm për të gjetur punë për viktimën, por gjithashtu se ai kontribuoi ndjeshëm në shfrytëzimin e saj të filluar nga F.T. Ai i transportoi F. T dhe A.K nga Shtime në Gjilan. Pa këtë ndihmesë do të kishte qenë shumë më e vështirë që A. të transferohej në restorantin me pronar M.K. Sipas A.K, I.I ishte shok i ngushtë i F. T është (shih dëshminë e saj f. 13, proces-verbal i datës 8 nëntor 2011).

Vlen të ceket se termi i shfrytëzimit nuk kufizohet në situatën ku nga vetë kryerësi është siguruar përfitim. Në pikëpamjen e Gjykatës, sjellja e I.I i plotësoi të gjitha rrethanat e veprës së trafikimit të personit për qëllimin e shfrytëzimit, duke u përputhur plotësisht me provat e administruara.

Nuk ka dyshim për Gjykatën se I.I, duke vepruar në marrëveshje me F.T, e transportoi viktimën nëpër Kosovë dhe më pas e transferoi atë tek të bashkë-pandehurit R.K dhe M.K. Në pikëpamjen e Gjykatës, nuk mund të kontestohet gjithashtu se A.K, duke pasur një pamje fizike shumë të re, dukej nën moshën 15 vjeç. I.I duhet ta ketë ditur se ajo ishte femijë nën moshë madhore. Ai vetë pranoi se ajo iu duk shumë e re.

Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me F.T dhe duke shkëmbyer mesazhe SMS me të, që janë në shkresat e lëndës, ai duhet të ketë ditur gjithashtu për varësinë e saj nga F.T dhe gjithashtu varësinë e saj nga droga. Ai ishte gjithashtu i vetëdijshëm se viktimja ishte sjellë nga jashtë dhe nuk e njohte Kosovën ose ndonjë person atje, përveç tij dhe F.




T. I.I gjithashtu e ruante viktimën në mungesë të F.T, ku asaj i ishte ndaluar të lëvizte lirisht pa I.IN. Gjykata është e mendimit se kjo sjellje e të pandehurit nuk u krye vetëm nga mirësjellja.

Të gjitha këto rrethana duhet t'i kenë dhënë I.I një pamje të qartë se ajo ishte në gjendje pambrojtshmërie të skajshme. Në këtë situatë, ai i gjeti punë në restorant Ai e njihte mirë atë vend, sepse ishte klient i rregullt atje. Në deklaratën e tij ai pranon se njihte mirë njërën prej kërcimtareve që punonte atje dhe kombësinë e kërcimtareve të tjera. Ai gjithashtu e njihte personalisht punëtorin e , R.K, dhe gjithashtu duhet ta ketë njohur realitetin dhe rreziqet që vinin nga puna atje si kërcimtare nate e re. E dëmtuara deklaroi se I.I i tha asaj një herë: "Mos rri në këtë restorant se je vetëm 16 vjeç". Për pasojë, duhet pranuar se qëllimi i I.I mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme nga rrethanat e lart-përmendura. Ai kontribuoi ndjeshëm në gjetjen e një pune për viktimën dhe ai e bëri këtë duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se kjo mund ose do të shpinte në shfrytëzimin e saj.

Fakti që viktima e konsideroi I.I "vëllanë" e saj i cili "e ndihmonte", nuk do të thotë se parakushti i qëllimit të të pandehurit nuk ishte prezent. Viktima nuk njihte askënd në Kosovë dhe në këtë mjedis të huaj gjeti dikë që nuk e trajtoi keq, i cili bisedoi me të, dhe madje e ndihmoi të gjente punë. Në të vërtetë, është pranuar se është pjesë e *modus operandi* të kryerësve të trafikimit, që ata përpiqen të shkaktojnë një gjendje varësie emocionale nga ana e viktimës së tyre, me qëllim që t'i mbajnë nën kontrollin e tyre për sa kohë të mundën. Sindroma e përshkruar më lart mund të cilësohet si strategjia e viktimës për të mbijetuar në kushtet e abuzimit të zgjatur dhe të rëndë ndërpersonal, që përfshin, ndër të tjera, të ashtuquajturin "identifikimin me kryerësin". Duke pasur parasysh këtë gjë, nuk ka dyshim për Gjykatën se një element mendor i kërkuar i veprës së trafikimit të personave është provuar dhe se I.I e ka kryer këtë vepër.

Fakti që ai u perceptua nga e dëmtuara si personi që e ndihmonte, është marrë nga Gjykata si rrethanë lehtësuese. Ky argument e solli Gjykatën në përfundimin se I.I i plotëson kriteret e përcaktuara nga nenet 66 dhe 67 të KPK-së, gjë që e lejon Gjykatën të zbusë dënimin e tij pa humbur nga fusha e pamjes qëllimin e dënimit dhe synimet e procedurës penale. Duke pasur parasysh që dënimi minimal i trafikimit të personave



është 3 vite burgim dhe ai maksimal është 15 vite burgim, dënimi me një vit duhet konsideruar dënim i butë dhe në përputhje me shkallën e dëmit të krimit të kryer nga i pandehuri.

## **R.K**

Nuk mund të kontestohet se ky i pandehur, duke vepruar në bashkë-kryerje me të bashkë-pandehurin M.K, e mori viktimën nga F.T dhe i bashkakuzuari I.I dhe e punësoi në restorantin ' ' si kërcimtare nate. Roli i tij në gjithë rastin ishte ai i ndërmjetësit midis pronarit të restorantit, M.K, nga njëra anë, dhe F.Tës dhe I.I, nga ana tjetër. Si menaxher i M.Kt, R.K kontribuoi kryesisht në punësimin viktimës. Në fakt ai ishte personi që e njëjti I.IN, pati biseda direkte me të lidhur me viktimën dhe kishte kontakt direkt me viktimën.

Nga deklarata e tij del se ai e dinte gjithashtu se viktimja ishte nën moshë. Duke punuar në restorant për ca kohë, ai ishte gjithashtu mjaft i vetëdijshëm se, duke ndihmuar në punësimin e viktimës nga M.K, ai do t'i siguronte asaj një punë që ka natyrë shfrytëzuese, pasi të gjitha kërcimtarët zakonisht merreshin nga klientë jashtë restorantit për qëllimin që është më se i dukshëm në kontekstin e punës që kryenin ato. Në këtë kontekst është edhe çështja e pambrojtshmërisë së veçantë të viktimës, për shkak të gjendjes së brishtë mendore të saj – një problem për të cilin i pandehuri ishte në dijeni. Në mendimin e Gjykatës, qëllimi i akteve të R.Kt ishte në fakt dhënia e kontributit në marrjen e saj në restorant ' ', ku prirja ishte që ajo të shfrytëzohej seksualisht nga klientët e restorantit. Duhet nënvizuar se i pandehuri duhet ta ketë ditur në mënyrë të arsyeshme që A. K ishte viktimë e një veprë penale, pasi ajo u soll tek ai nga dy burra që nuk kishin lidhje farefisnie me të, pa ndonjë mjet dhe letërnjoftim, por me varësi të dukshme nga droga dhe e mitur. Megjithatë, duke i ditur të gjitha këto, si punonjës i M. K.it, ai bashkëvendosi ta merrte atë atje për qëllimet e shfrytëzimit të saj, duke kryer me këtë veprën penale të trafikimit të personave.

Fakti që ai ishte thjesht ndërmjetës, pa ndonjë fuqi vendimtare, dhe nuk siguroi ndonjë përfitim për veten nga kjo, e lejon Gjykatën t'i trajtojë këto rrethana si lehtësuese. Ky argument e solli Gjykatën në përfundimin se R.K i plotëson kriteret e parashikuara




nga nenet 66 dhe 67 të KPK-së, që e lejojnë Gjykatën të zbusë dënimin e tij, pa humbur nga fushëpamja qëllimin e dënimit dhe synimet e procedurës penale. Duke pasur parasysh që dënimi minimal në trafikimin e njerëzve është 3 vite burgim dhe ai maksimal është 15 vite burgim, dënimi prej një viti duhet konsideruar dënim i butë dhe në përputhje me shkallën e dëmit të krimit të kryer nga i pandehuri.

## M.K

M.K vendosi ta punësonte viktimën në restorantin e tij si kërcimtare nate, duke ditur se vajza e re e pambrojtur që punonte mes klientëve meshkuj ishte e ekspozuar ndaj kërkesave për seks, dhe ai ishte plotësisht i vetëdijshëm se prania e një kërcimtareje të re në restorantin e tij do të tërhiqte më shumë klientë. Qëllimi i veprimeve të M.K lidhej drejtpërdrejt me shfrytëzimin e saj prej tij dhe biznesi i tij. I pandehuri ishte i vetëdijshëm për moshën e re të viktimës dhe se ai e kishte punësuar atë për të punuar natën në kushte të rrezikshme. Kjo rrethanë është e zbatueshme për të dyja: atë që ka të bëjë me veprën e shkeljes së të drejtave në punë, dhe tjetrën, lidhur me veprën e trafikimit të personave. Viktima ishte e ekspozuar ndaj kushteve në të cilat asaj mund t'i bëheshin kërkesa për seks nga klientë të restorantit. Kjo e bën qëllimin e M.K të qartë për Gjykatën.

M.K edhe si pronar i restorantit i kreu veprat penale të tij pa përcaktuar shkallën e lartë të dëmit të tyre. Ai punësoi personin që u soll në restorantin e tij. A.K tregoi për M.Kn se ai i kishte thënë se ajo nuk mund të punonte atje, sepse nuk kishte pasaportë dhe po të vinte policia të kontrollonte, ajo do ta mbyllte lokalin, sepse ai (pronari) nuk do të provonte dot se ajo ishte 19 vjeç (shih dëshminë e saj f. 15, proces-verbal i datës 8 nëntor 2011). Për Gjykatën ishte e qartë se ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për moshën jomadhore të saj. Me gjithë këtë, ai nuk e kundërshtoi punësimin e saj. E vetmja gjë problematike për të ishte si të provonte moshën e saj në rast se policia vinte në lokal. Ajo u lirua nga restoranti i tij tre ditë më pas. Faktet e lart-përmendura e sollën Gjykatën në përfundimin se duhet zbatuar zbutja e dënimit për M.K, veçanërisht sepse edhe dënimi më i ulët i kërkuar për veprën e trafikimit të personave (3 vite burgim) nuk do të përputhej me nivelin e fajësisë së të pandehurit. Sipas Gjykatës M.K i plotëson kriteret e parashikuara nga nenet 66 dhe 67 të KPK-së, që e lejojnë Gjykatën të zbusë dënimin e tij pa humbur nga fushëpamja qëllimin e dënimit dhe synimet e procedurës penale. Duke



pasur parasysh që dënimi minimal në trafikimin e njerëzve është 3 vite burgim dhe ai maksimal është 15 vite burgim, dënimi prej një viti duhet konsideruar dënim i butë dhe në përputhje me shkallën e dëmit të krimit të kryer nga i pandehuri. Lidhur me veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës, Gjykata ia përshtati dënimin peshës së veprës penale në rastin individual të të pandehurit, duke e dënuar atë me burgim në afat 6 (gjashtë) muaj. Për mendimin e Gjykatës, dënimi unik prej 1 viti dhe 1 muaji është dënimi më i mjaftueshëm për M.KN. Vlen të ceket se në caktimin e dënimit unik ndaj të pandehurit, Gjykata zbatoi rregullin e absorbimit të dënimeve.

### Sh.G

Rasti i të pandehurit Sh.G është veçanërisht flagrant nga këndvështrimi i veprës penale të trafikimit të personave. Ai e dinte se viktima ishte nën moshë madhore dhe megjithatë e punësoi atë në restorantin e tij si kërcimtare nate, në kushte në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks. Para kësaj ai e mori viktimën nga F.T - një person që ai pothuajse nuk e njhte. Për më tepër, kur viktima erdhi në lokalën e tij, ajo nuk kishte asnjë mjet ose sende personale. Të gjitha këto rrethana duhej të kishin shkaktuar dyshimin e tij lidhur me faktin se ajo mund të ishte viktimë e trafikimit të personave. Po kështu, ai ushtroi efektivisht kontroll mbi viktimën – atë e kyçën në dhomën e saj për të mos e lënë të largohej kur ajo vendosi ta linte punën. Kur ajo arriti të shpëtonte, Sh.G dhe katër individë të tjerë të cilët vepruan me kërkesë të tij, e kthyen atë me forcë në restorant. Me këtë është e qartë për Gjykatën që ai e konsideronte viktimën si pronë të tij të çmuar, pasi ai mori të gjithë hapat për ta mbajtur atë edhe pa pëlqimin e saj. Kur A. u arratis përmes dritares nga Restorant Sh.ni iu vu pas me persona të tjerë, dhe ata e urdhëruan atë të hynte në kerr. Atë e përplasën tek dritarja dhe Sh.ni mori shkopin e beizbollit dhe donte ta godiste me shkop, por një tjetër ia mori shkopin nga duart (shih dëshminë e saj f. 16, proces-verbal i datës 8 nëntor 2011). A.K dëshmoi gjithashtu se Sh.G iu afrua asaj duke i thënë se ajo duhet të qëndrojë në Restorant dhe nuk duhet të lëvizë nga ai vend, duke theksuar se kur ishte atje, ajo do të bënte çdo gjë që i thoshte ai, sepse ky ishte lokali i tij (shih dëshminë e saj f. 15, proces-verbal i datës 8 nëntor 2011).





Për më tepër, duke qenë pronar i restorantit, Sh.G duhet të ketë ditur nga praktika se një vajzë e re që punon si kërcimtare nate dhe e kalon kohën mes klientëve meshkujve, ishte e ekspozuar ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual. Edhe pse i vetëdijshëm për këtë, prapëseprapë ai nuk u tërhoq para këtij rreziku. Në këtë drejtim, si shembull, mund të parashtrijmë edhe incidentin kur njëri prej klientëve të restorantit me emrin [REDAKTUAR] tentoi ta puthë viktimën kur ajo po punonte. I pandehuri ishte në dijeni të këtij incidenti, sepse nga ky moment ai filloi ta keqtrajtojë viktimën. Po kështu, sipas deklaratës së viktimës, klientët e restorantit i kërkonin asaj të shkonte me ta dhe i pandehuri e dinte këtë.

Sh.G ishte gjithashtu i vetëdijshëm për cenueshmërinë mendore të viktimës. Sipas B. H, viktima sillej “sikur ishte e droguar, sikur ishte nën ndikimin e drogës”. Nëse ky dëshmitar (që ishte vetëm muzikant) e vuri re këtë, Gjykata nuk ka dyshim se edhe i pandehuri si pronar dhe menaxher i restorantit duhet ta ketë ditur këtë. Të gjitha rrethanat e cekura, të vlerësuara së bashku, duhet të shpien në përfundimin e pashmangshëm se qëllimi specifik nga ana e të pandehurit (“qëllimi i shfrytëzimit”) është realizuar, sepse ai e punësoi viktimën duke qenë në dijeni se asaj do t’i bëheshin kërkesa për seks, dhe e mbajti atë forcërisht në lokalin e tij për këtë qëllim.

Shtjellimi i mësipërm për qëllimin e veprës së trafikimit të personave dhe veprës së privimit të paligjshëm të lirisë (Neni 162 § 1 dhe 4 i KPK-së) është në të njëjtën kohë i vlefshëm dhe i zbatueshëm për veprën e shkeljes së të drejtave nga marrëdhëniet e punës (Neni 182 i KPK-së).

Gjykata nuk ka pikasur asnjë rrethanë lehtësuese kur ka caktuar dënimet për të tre akuzat. I pandehuri veproi qëllimisht dhe me dije të plotë të veçantisë së pozitës së të dëmtuarës. Ai veproi vetëm për të siguruar përfitim nga aktivitetet e saj në restorantin e tij. Pa rrethana lehtësuese, Gjykata e dënoi atë me 4 vite burgim për veprën penale të trafikimit të personave. Dënimi e kalon paksa minimumin e tre viteve burgim të parashikuar nga Kodi Penal i Kosovës.

Për veprën penale të privimit të paligjshëm të lirisë, Gjykata e dënoi atë me 1 vit e 6 muaj burgim dhe, pas kësaj, për veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës, Gjykata e dënoi të pandehurin me 6 muaj burgim duke i bërë dënimet të mjaftueshme dhe në përputhje me ndihmesën e tij në këto vepra penale dhe shkallën kriminale të dëmit të tyre. Për pasojë, Gjykata caktoi ndaj Sh.Gt dënimin unik



me burgim në afat prej 4 vitesh dhe 1 muaji, duke zbatuar me këtë rregullin e absorbimit të dënimeve, që e bën dënimin unik më të favorshëm për të pandehurin.

### V.M

Ky i pandehur është akuzuar se ka kryer veprën e lehtësimit të kryerjes së trafikimit me njerëz nga pakujdesia, sipas Nenit 139(4) të KPK-së. V.M, me dijeninë se viktima ishte e mitur dhe se S.B kishte të ngjarë të gjente punësim për të në një kazino (qartazi vend i rrezikshëm, ku viktimit mund t'i bëheshin kërkesa për seks dhe në fakt të shfrytëzohej), e transportoi viktimit me automjetin e tij në motel, dhe rregulloi akomodimin për të, pagoi dhomën e saj dhe me këtë e strehoi atë. Ai gjithashtu i dha viktimit numrin e mobilit të S. B. Të gjitha këto akte të V.M – të kryera në pakujdesi – kontribuan në kryerjen e veprës së trafikimit nga S.B.

Për mendimin e Gjykatës, i pandehuri në mënyrë të arsyeshme duhet të ketë pasur dijeni për situatën e viktimit. Nga provat e siguruar është evidente se në dhjetor 2010 V.M, S.B dhe viktima u takuan me një person të quajtur T., i cili u përpoq ta detyronte viktimit të kthehej me të në Shqipëri. V.M mësoi nga viktima se F.T i dha të holla T. për ta marrë viktimit në Kosovë. Ai gjithashtu mësoi se T. e detyronte atë të bënte seks me njerëz të ndryshëm në Kosovë. Për mendimin e Gjykatës, V.M e dinte se A. K ishte viktimit e trafikimit dhe me aktet e tij ai lehtësoi trafikimin e mëtejshëm të saj nga S.B. Ky përfundim mund të nxirret nga deklaratat e së dëmtuarës, V.M, S. B dhe gjithashtu pjesërisht nga transkriptet e thirrjeve telefonike ndërmjet V.M dhe personit të panjohur, datë 05/01/2011. Për mendimin e Gjykatës, kjo duhet të shpjegohet në përfundimin se ekzistenca e një elementi të kërkuar mendor të veprës së trafikimit të personave është provuar dhe V.M e ka kryer këtë vepër me të cilën akuzohet.

Duke marrë parasysh se V.M ishte duke vepruar nga pakujdesia dhe duke vlerësuar shkallën e dëmit të veprës penale të kryer prej tij, del se dënimi i mjaftueshëm dhe përkatës do të ishte afër kufirit të dënimin minimal ligjor. Prandaj Gjykata caktoi ndaj tij dënimin me 7 muaj burgim.



S.B

Për mendimin e Gjykatës, nuk kishte dyshim lidhur me faktin se S.B veproi me qëllim të "shfrytëzimit" të të dëmtuarës. Fakti që A.K deklaroi se S. ishte i dashuri i [REDAKTUAR] (kjo e fundit ishte kërcimtare tjetër, kolege e A.ës) tregon se ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për veçantinë e punës së të dëmtuarës, veçanërisht për pambrojtshmërinë ndaj kërkesave për seks. Sipas deklaratave të saj, S. kinse i tha A.ës se Sh.G nuk ishte njeri i mirë, por në fakt ai nuk mori asnjë hap për ta ndryshuar situatën e të dëmtuarës, ose për ta ndihmuar të lirohej. Sipas të dëmtuarës, ishte S.B ai i cili në pjesën më të madhe kontribuoi për gjetjen e punës për të në [REDAKTUAR]. Sipas të dëmtuarës, pasi S.B dhe V.M i ofruan ndihmën e tyre A.ës, S.B i tha A.ës se ai do t'i gjente asaj një punë të re si bariste në Casino Piano bar. Më ose rreth datës 24.12.2010, S. e solli A.Kn në [REDAKTUAR] dhe bashkë me D. B, ranë dakord që rroga e saj të ishte 300 euro në muaj (shih dëshminë e saj f. 17, proces-verbal i datës 8 nëntor 2011). S.B veproi jo vetëm për t'i gjetur punë viktimës, por kontribuoi gjithashtu ndjeshëm në shfrytëzimin e saj të filluar nga D. B. S.B nuk e parandaloi shfrytëzimin e mëtejshëm të viktimës. Nuk ka dyshim, për mendimin e Gjykatës, se ai e kreu veprën penale të trafikimit të personave.

S.B pretendon se nuk e kuptoi moshën e A.K. Në këtë drejtim, deklarata e të pandehurit nuk është dashur të konsiderohet e besueshme dhe për mendimin e Gjykatës kjo përbën linjën e tij të mbrojtjes. Për më tepër, ajo nuk është bindëse për shkak të pamjes feminare fizike të saj, që duhet marrë e dukshme pas analizës së fotos së saj të përfshirë në tërësinë e provave. I pandehuri kreu gjithashtu marrëdhënie seksuale me A.Kn. Ajo pretendoi se kjo ndodhi kur ata ishin të dy të pirë dhe me pëlqimin e saj. Megjithëse ajo e pranoi faktin e kryerjes së marrëdhënies seksuale me të, kjo rrethanë është e mjaftueshme që Gjykata të arrijë në përfundimin se i pandehuri e kreu veprën penale të abuzimit seksual të personit nën moshën 16 vjeç, duke kryer marrëdhënie me të miturën. Në këtë lloj të veprës penale nuk ka mbrojtje duke treguar se viktima e dha pëlqimin – madje as që i pandehuri nuk e kuptoi moshën e viktimës. Në këtë rast nuk ka mbrojtje që S.B me arsye besoi se A.K nuk ishte e mitur. Ky besim nuk kishte baza të arsyeshme pasi u bë analiza e fotove të saj, të cilat u përfshinë në tërësinë e provave.



S.B ishte vetëm ndërmjetës, pa ndonjë fuqi vendimtare, dhe nuk siguroi ndonjë përfitim për veten nga kjo. Rrethana e lart-përmendur e lejon Gjykatën ta trajtojë atë si lehtësuese. Ky argument e solli Gjykatën në përfundimin se S.B i plotëson kriteret e parashikuara nga nenet 66 dhe 67 të KPK-së, që e lejojnë Gjykatën të zbusë dënimin e tij, pa humbër nga fushëpamja qëllimin e dënimit dhe synimet e procedurës penale. Duke pasur parasysh që dënimi minimal në trafikimin e njerëzve është 3 vite burgim dhe ai maksimal është 15 vite burgim, dënimi prej një viti duhet konsideruar dënim i butë dhe në përputhje me shkallën e dëmit të veprës penale të kryer nga i pandehuri. E mësipërmja zbatohet edhe për veprën penale të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeç. Sipas Nenit 198 paragrafi 1 të KPK-së, që parashikon dënimin nga një vit deri në dhjetë vjet, dënimi me 1 vit burgim është relativisht i butë. Gjykata caktoi një dënim unik që e kalon paksa rregullin e absorbimit të plotë të dënimeve.

#### **D.B**

Rasti i të pandehurit D.B nga këndvështrimi i veprës penale të trafikimit të personave ishte relativisht i qartë. D. e dinte se viktimja ishte e mitur dhe prapëseprapë e punësoi atë në restorantin e tij si kameriere, në kushtet në të cilat ajo ishte e cënueshme ndaj kërkesave për seks. Para kësaj, ai e mori viktimën nga S.B dhe V.M. Për më tepër, kur erdhi në lokalin e tij, viktimja nuk kishte asnjë mjet apo send personal. Të gjitha këto rrethana duhej ta kishin bërë të dyshonte se ajo mund të ishte viktimë e trafikimit të personave. Po kështu, ai ushtroi efektivisht kontroll mbi viktimën në periudhën e kaluar në lokalin e tij.

Me këtë, për Gjykatën është e qartë se i pandehuri e konsideroi viktimën si pronë të vyer të tij, ngase ai mori të gjithë hapat për ta mbajtur atë edhe pa pëlqimin e saj. Për më tepër, duke qenë menaxher i restorantit, D. B. duhet të ketë ditur nga praktika se një vajzë e re që punon si kameriere në orët e natës dhe kalon kohë mes klientëve meshkuj, ishte e ekspozuar ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual. Duke qenë i vetëdijshëm për këtë, ai prapëseprapë e pranoi këtë rrezik. Kur festoi Vitin e Ri, D.B e mori A.Kn në shtëpinë e tij dhe duke qenë të dy të pirë, kryen marrëdhënie seksuale (shih dëshminë e saj f.15 proces-verbal i datës 8 nëntor 2011). I pandehuri D.B e bëri këtë më ose rreth datës 24



dhjetor 2010. Pastaj, duke pasur frikë nga policia, D.B vendosi ta transferonte A.KN nga restoranti i tij. Lidhur me marrëdhënien seksuale të D. B me të dëmtuarën e mitur, Gjykata duhet të theksojë se dëshmia e A.Kt dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, ku ajo e mohoi të kishte pasur marrëdhënie seksuale me të pandehurin, nuk është e besueshme. Dëshmia e saj u shmang nga ajo që deklaroi gjatë hetimit dhe madje pjesërisht edhe në shqyrtimin kryesor. A.K donte ta zvogëlonte dukshëm përgjegjësinë e tij kur dëshmoi në shqyrtimin kryesor. Për mendimin e Gjykatës, ky ndryshim i dëshmisë nuk u shpjegua në mënyrë të besueshme, për ta trajtuar si version të pranueshëm.

Të gjitha rrethanat e lart-përmendura të vlerësuara së bashku duhet të shpien në përfundimin e pashmangshëm se qëllimi specifik nga ana e të pandehurit ("qëllimi i shfrytëzimit") u realizua kur ai e punësoi viktimën me dijeninë se asaj mund t'i bëheshin kërkesa për seks, dhe e mbajti atë me forcë në lokalit të tij për këtë qëllim. Ai kreu veprën penale të trafikimit të personave dhe për këtë veprë penale Gjykata e dënoi me burgim në afat prej 1 viti. Sipas Gjykatës, edhe dënimi më i ulët i kërkuar për veprën e trafikimit të personave (3 vite burgim) nuk do të përputhej me nivelin e fajësisë së të pandehurit D.B dhe me përfitimet e siguruar nga punësimi i të dëmtuarës. Duke pasur parasysh që dënimi minimal në trafikimin e njerëzve është 3 vite burgim dhe ai maksimal është 15 vite burgim, dënimi prej një viti burgim si dënim i lehtësuar duhet konsideruar dënim i butë dhe në përputhje me shkallën e dëmit të shkaktuar nga krimi i kryer nga i pandehuri. Sipas Gjykatës, kriteret e parashikuara nga nenet 66 dhe 67 të KPK-së zbatohen edhe për D. B dhe e lejojnë Gjykatën ta zbusë dënimin e tij, pa humbur nga fushëpamja qëllimin e dënimin dhe synimet e procedurës penale.

I pandehuri, në data të paditura ndërmjet 24.04.2010 dhe 31.12.2010, e bëri të dëmtuarën e mitur A.K, objekt të një akti seksual, duke kryer marrëdhënie seksuale me të. Me këtë ai kreu veprën penale të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeç, ndaj Gjykata e dënoi me burgim në afat 1 viti.

I pandehuri, ndërmjet datave 24.12.2010 dhe 31.12.2010, me dijeni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës, duke e punësuar dhe duke e angazhuar A.K në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj; ai e angazhoi atë në punë nate dhe e punësoi për më shumë se 30 orë në javë (Neni 20), duke kufizuar në këtë mënyrë të drejtat që gëzonte punonjësja




A.K. Me këtë ai kreu veprën penale të cenimit të të drejtave nga marrëdhëniet e punës dhe Gjykata e dënoi atë me burgim në afat 6 muaj.

Për të gjitha veprat e njëkohshme penale, Gjykata caktoi ndaj D. B dënimin unik me burgim në afat prej 2 vitesh. Vlen të ceket se, kur caktoi dënimin unik ndaj të pandehurit, Gjykata zbatoi rregullin e absorbimit të pjesshëm të dënimeve.

## **E.K**

Në fakt A.K punoi në restorantin e të pandehurit vetëm 2 orë. Kjo rrethanë mund të përbëjë element lehtësues. Megjithatë Gjykata thekson se sipas Nenit 139 të KPK-së, nuk ka element të kohës gjatë së cilës kryhet kjo veprë penale për ta konsideruar të përfunduar. Për ta konsideruar të kryer veprën e trafikimit të personave duhen vërtetuar këto elemente: akti si i tillë (rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi), mjetet (përfshirë fëmijën) dhe qëllimi shfrytëzues. E.K “e mori” (akti) të dëmtuarën e mitur nga dy persona të panjohur, për qëllime të punësimit të saj si kërcimtare gjatë natës në restorantin e tij, në rrethana në të cilat ajo ishte e pambrojtur ndaj kërkesave për seks nga klientët (qëllimi shfrytëzues). Vlen të theksohet se E.K i tha A.K se ajo duhej të largohej po të vinte policia. Ai e këshilloi atë të largohej menjëherë po të hynte policia në lokal (shih dëshminë e saj f. 11, proces-verbal i datës 9 nëntor 2011). Kjo tregon ekzistencën e elementit mendor të veprës penale të kryer prej tij. Nga rrethanat e lëndës, Gjykata është e mendimit se qëllimi i E.K për punësimin e viktimës ishte në fakt shfrytëzimi seksual i saj, ose shpuri në këtë shfrytëzim. Që ky lloj i veprës penale të kryhet, nuk është nevoja që kryerësi ta shfrytëzojë viktimën vetë, ose ta ketë këtë qëllim në lidhje me të.

Nuk ka dyshim se më 05.01.2011 i pandehuri kreu veprën penale të trafikimit të personave, siç cilësohet në dispozitiv. Megjithatë Gjykata vendosi për zbatimin e Nenit 66 paragrafi 2, Nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPK-së për lehtësim. Sipas Gjykatës, edhe dënimi më i ulët i kërkuar për veprën e trafikimit të personave (3 vite burgim) nuk do të përputhej me nivelin e fajësisë së të pandehurit E.K, duke marrë parasysh që viktima punoi në restorantin e tij vetëm dy orë. Duke pasur parasysh që dënimi minimal në trafikimin e njerëzve është 3 vite burgim, dhe ai maksimal është 15



vite burgim, dënimi prej një viti burgim si dënim i lehtësuar duhet konsideruar dënim i butë dhe në përputhje me shkallën e dëmit të krimit të kryer nga i pandehuri.

I pandehuri E.K u shpall fajtor sepse më 05.01.2011 me dijëni nuk e zbatoi Ligjin e Punës të Kosovës dhe punësoi një fëmijë (A.K) të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, për ta angazhuar në punë që ishte në dëm të zhvillimit të saj, duke i mohuar kështu të drejtat që gëzonte punonjësja, ndaj, për këtë veprë penale, Gjykata e dënoi atë me burgim në afat 6 muaj. Në caktimin e dënimit, Gjykata ka marrë parasysh periudhën e shkurtër të punësimit.

Për rrjedhojë, Gjykata caktoi ndaj E.K dënimin unik me burgim në afat 1 (një) vit dhe 3 (tre) muaj, që është bazuar në absorbimin e plotë të dënimeve individuale.

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e lart-përmendura, Gjykata shqiptoi këtë Aktgjykim.


\_\_\_\_\_  
Witold Jakimko  
Kryetar i trupit gjykues  
për të mitur

\_\_\_\_\_  
Lulzim Paqarizi  
Anëtar i trupit gjykues

\_\_\_\_\_  
Kymete Kicaj  
Anëtare e trupit gjykues

\_\_\_\_\_  
Matti Aalto  
Proces-mbajtës

**MJET LIGJOR:** Në bazë të Nenit 398(1) të KPPK-së, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur atyre u dorëzohet kopja e tij.



Republika e Kosovës  
Kosova Gumburlyeti  
KOSOVA GUMBURLYETI  
TAÇNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE  
BU KOPYANIN ASLMA UYGUN OLDUĞU TASDIK EDILIR  
Punëtori i autorizuar  
Ovlašćenil radnik  
Y.K. 11/11